



Pjesmarrës në tubimin e datës 16.11.2013

*Zofingen, 16.11.2013*

## **U mbajt kuvendi i rregullt i Shoqates Humanitare „Jerina“**

Në Zofingen të Zvicres, në klubin Dardania, sikurse edhe herave t` tjera, u mbajt Kuvendi II i rregullt i Shoqates Humanitare “Jerina” për Zvicer e cila i bashkon bashkëvendasit e Fshatit Botushë.

Rendi i ditës:

1. Kuvendi i II I Shoqates Humanitare “Jerina”
2. Të ndryshme.

Të Pranishëm ishin: *Muhamet (Mustafa) Aliu, Asllan (Elez) Salihu, Bedrush (Lanë) Mehmeti, Avni Kadrija, Islam (Adem) Sadiki, Shaban (Qazim) Avdija, Tahir (Lanë) Mehmeti, Muhamet (Dervish) Botusha, Fahri (Muhamet) Aliu, Tahir dhe Jeton Nimoni, Blerim Avdija, Fahri (Ramadan) Avdyli, Artan Sadiki dhe Bajram (Rrustem) Mehmeti.*

Tubimin e hapi ish Kryetari i deritanishëm z. Bajram Mehmeti ku ne fillim i pershëndeti të gjith të pranishmit e në veqanti Musafiret si Muhamet Mustafen dhe disa të rinjë që kan ardhë për here të pare.

Kuvendi i rregullt mbahet në bazë të Statutit i cili përcakton se qdo 2 vite të mbahet Kuvendi Zgedhorë.

Me pas ju dha fjala secilit veq e veq që të diskutoin për punën e gjeritanishme dhe për propozimet për Kryesin e re:

- **Asllan Salihu.** Kemi punuar aq sa kemi pasë muni dhe kapacitet. Kemi berë një punë të mirë dhe modeste. Jam dhe propuzoi që Bajram Mehmeti të rizgjidhet edhe për një mandat Kryetarë i Shoqates.
- **Islam Sadiki** propuzoi që tër Kryesija e gjeritanishme të rizgjedhet edhe për Dy vite.
- **Muhamet Aliu,** pajtohet qe Bajrami të rizgjidhet edhe për një mandat Kryetarë i Shoqates.
- **Avni Kadrija** ishte i po të njejtit mendim.
- **Muhamet Botusha-** Pajtohet me parafolsit por benë një kritikë per të gjithë ata anëtarë të Kryesisë që disa herë me radhë nuk po marrin pjesë në Tubime.
- **Bedrush Mehmeti** - Kerkoj te di se kush ishte anëtar i Kryesisë deri me tani qe te di këndë ta propozoi për në të ardhmen.
- **Tahir Mehmeti.** Propozon Bajramin për Kryetarë dhe kryesia te mbetet ashtu siq ka qenë.

Më pasë u Votua ku me shumicë Apsolute, pa astenji kundër, Kryetarë u zgjodh z. Bajram Mehmeti.

Më pas u bë zgjedhja e anëtarëve të kryesisë.

- **Asllan Salihu,** u zgjodhë nënkryetari i parë.
- **Shaban Avdija,** nënkryetari i dytë
- **Muhamet Botusha,** Arkatarë
- **Tahir Mehmeti,** Kordinatorë
- **Islam Sadiki,** Sekretarë

- **Fahri Avdyli, Anëtarë**
- **Fahri Aliu**
- **Avni Kadrija**
- **Bedrush Mehmeti**
- **Ramë Botusha**
- **Arif Botusha**
- **Jeton Nimoni**
- **Tahir Nimoni**
- **Naim Zajmi**
- **Hysni Salihu**
- **Fidan Meta**
- **Ismet Sadiku**
- **Xhevdet Lama.**

Në bazë të kërkesave të shumta u aprovua kërkesa që të zgjidhet edhe një nënkryetarë i tretë. U propozua dhe u zgjodh njëzërit Fahri Aliu.

Arkatari dha raportin e gjendjes momentale si dhe numrin e pagesave të antarësisë.

Në piken e dytë të rendit të dites u diskutua munsija e zgjerimit të shoqates edhe në shtetet e tjera jashta Zvicres si në Austri, Gjermani dhe Suedi. Që të formohen berthamat e shoqates në keto shtete u propozuan këta bashkëvendas që ti kordinojn punet dhe te formojnë këshillet iniciuse.

1. **Suedi- Haxhi Haxhiu**
2. **Austri – Besim Deliu**
3. **Gjermani Halil Ademi, Shkelzen Ahmeti dhe Ramiz Nimoni**

U cekë se nese edhe në shtetet e tjera ka interes që të formohen degët e Shoqates, i lusim

incijatoret qe të marrin kontakte me ne, për kordinim të punëve.

Bajram Mehmeti propozoi që ti behet një kërkesë Kuvendit komunal të Gjakovës për zgjerimin e Urës mbi Gushë në hyrje të fshatit. Peticioni të behet me mbledhjen e nënshkrimeve dhe ti dergohet komunës në menyrë Protekulare. Kërkesa u aprovua njëzërit.

Për qeshtjen e Shtepisë së Kultures që kemi biseduar në dy tubimet e mëparshme, u cek që po presim deri sa të gjindet plani adekuat, shpronsimi dhe definimi i pronës ku është caktuar që të ndertohet dhe të dihet përafersishtë shuma e investimit.

Tubimi përfundoi si gjithmonë në frymën